



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

ZL. Anr.129/2025

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Arsim Hamzaj - kryesues, Kymete Kicaj dhe Skender Çoçaj anëtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, parashtruar kundër subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë fushatës zgjedhore për Zgjedhjet Lokale 2025, që do të mbahen me datë 12 Tetor 2025, në seancën e panelit të mbajtur më datë 10.10.2025, merr këtë :

V E N D I M

REFUZOHET e pabazuar ankesa ZL.Anr.129/2025, e datës 07.10.2025, parashtruar nga Subjektit Politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, paraqitur kundër Subjektit Politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët gjatë fushatës zgjedhore për Zgjedhjet Lokale, që do të mbahen më datë 12 Tetor 2025.

A r s y e t i m

Me datë 07.10.2025 ne PZAP-i, është parashtruar ankesë nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV) me seli në Komuna Prishtinë, në të cilën pretendohet se me datë 06.10.2025 rreth orës 17:00, aktivistët e Qendrës së Lëvizjes Vetëvendosje! në Prishtinë, kanë vërejtur se: kandidati për kryetar të Komunës së Prishtinës nga subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës, z.Përparim Rama, nga facebook faqja e tij ka shpërndarë Video të punëtorëve të Ndërmarrjes Publike Pastrimi Sh.A dhe punëtorëve të Ndërmarrjes Publike Banësore SH,A gjatë procesit të punës, prodhimit të kontejnerëve të mbeturinave në ambientet e punës ndërsa në fund të videos shfaqet slogani i subjektit politik LDK "Prishtina përtej" dhe numri i këtij subjekti politik për Zgjedhjet Lokale të datës 18 tetor 2025. Provë: <https://www.facebook.com/ree1/3122526661260510> Video linku i publikuar në facebook faqen e kandidatit Përparim Rama. LDK-Prishtinë. Me këtë veprim, subjekti politik LDK, ka shkelur dispozitat e nenit 36 të LZP-së duke përdor resurset publike apo pozitën e nëpunësve të Ndërmarrjes Publike Lokale me qëllim të fitimit të votave. Andaj, duke u mbështetur në

bazën ligjore dhe argumentet e lartcekura, kërkojmë që masa e sanksionit të vendoset në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Në përgjigje në ankesë të subjekti politik LDK thekson se videoja e publikuar në faqen zyrtare të kandidatit për kryetar të Komunës së Prishtinës, z. Përparim Rama, nuk është realizuar gjatë fushatës zgjedhore të vitit 2025, dhe se bëhet fjalë për një material të regjistruar dhe të publikuar më herët, konkretisht para rreth dy vitesh në kohën kur janë pranuar dhe vendosur kontejnerët e rinj nga Ndërmarrja Publike Banesore dhe Ndërmarrja Publike Pastrimi Sh.A. Ky fakt mund të verifikohet lehtësisht nga data e publikimit fillestar të videos, e cila është e qasshme dhe tregon se videoja nuk ka lidhje me aktivitetet e tanishme zgjedhore. Publikimi i përsëritur i materialit nuk e shndërron atë në veprim të ndaluar zgjedhor dhe as nuk paraqet Shkelje të nenit 36 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme (LZP). Është me rëndësi të theksohet se neni 36 i LZP-së ndalon qartë përdorimin e resurseve dhe institucioneve publike gjatë periudhës së fushatës zgjedhore, mirëpo ky nen nuk ndalon publikimin apo shpërndarjen e materialeve (foto apo Video) që janë krijuar vite më parë, jashtë periudhës zgjedhore, dhe që nuk janë prodhuar për qëllime të tanishme zgjedhore. Prandaj, pretendimi i subjektit politik ankimues se është përdorur pozita e punonjësve të ndërmarrjeve publike për qëllime të fushatës nuk qëndron, pasi procesi i xhirimit dhe publikimit është kryer shumë më herët në kuadër të detyrave të rregullta institucionale, dhe jo gjatë fushatës së vitit 2025. Kjo video është bërë gjatë vitit 2024, me saktësisht 10 shkurt dhe 16 shkurt të 2024. Andaj, sqarojmë se materiali i publikuar nuk është realizuar gjatë periudhës së fushatës zgjedhore, por para saj, Konkretisht me datë 10 shkurt 2024 është realizuar videoja me punëtorët e njëjtë, ndërsa me datë 16 shkurt 2024 janë realizuar fotografitë me të gjitha kontejnerët e rinj. Një element tjetër i rëndësishëm që e dëshmon këtë është fakti se edhe veshja e kryetarit dhe zyrtarëve të tjerë është e njëjtë, çka e forcon argumentin se këto materiale i përkasin atyre datave dhe jo periudhës aktuale të fushatës. Këto kanë qenë punë të kryetarit Rama, për të cilat Kryeqytetit ka kontratë me NPB, për kryerjen e këtyre punëve, nuk është shkuar tek punët e tyre të cilat ata i kryejnë në përditshmëri dhe të bej video, por në projektet e tij gjatë atij viti. Ndërsa video tjera e bashkangjitur është me 6 prill 2024, ku të gjitha janë i gjeni të bashkangjitura: Fotot(dëshmi) dhe linkun të cilat gjenden ne faqen zyrtare, në forme video dhe foto me data e lartcekura,

Me tej ne përgjigje theksohet se nëse z. Rama gjatë debatit në fushatë thekson se ka realizuar rreth 2000 kontejnerë të rinj dhe se kjo është një punë e mirë, duke e përdorur si argument për të kërkuar mbështetjen e qytetarëve, kjo nuk përbën shkelje të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme. Arsyeja është se bëhet fjalë për prezantim të projekteve dhe rezultateve të arritura gjatë mandatit të tij si kryetar, gjë që është praktikë e zakonshme në fushata zgjedhore në Kosovë dhe kudo tjetër. Sepse nëse ndjeket kjo logjikë duhet të dënohet për secilën fjalë, sepse është kryetar aktual dhe me punë gjatë mandatit do të kërkoj votë. Ligji ndalon përdorimin e resurseve institucionale gjatë periudhës së fushatës (siç janë zyrat, automjetet, punëtorët e komunës gjatë orarit të punës ose buxheti publik për qëllime politike), por nuk ndalon që një kandidat të pasqyrojë punën dhe projektet e tij të realizuara në mandatin e kaluar, Prandaj, një deklaratë e tillë në debat publik konsiderohet thjesht prezantim i rezultateve të punës dhe i arritjeve, jo shfrytëzim i institucioneve për propagandë, dhe rrjedhimisht nuk përbën shkelje ligjore. Gjithashtu, dëshirojmë të theksojmë se publikimi i këtij materiali ka qenë vetëm një përmbledhje e punës së kryer në të kaluarën, një praktikë e

zakonshme e cila bëhet edhe nga subjektet dhe partitë e tjera politike, dhe nuk ka për qëllim përdorimin e institucioneve për përfitime zgjedhore. Për rrjedhojë, nuk mund të konstatohet asnjë shkelje e Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme, pasi materiali nuk është i prodhuar gjatë fushatës dhe as nuk paraqet propagandë institucionale të ndaluar nga ligji, por thjesht një pasqyrim i punës së mëhershme. Andaj, kërkojmë që Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), duke u mbështetur në provat dhe faktet reale mbi datën dhe rrethanat e krijimit të videos, të konstatojë se nuk ka pasur shkelje të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme dhe ta hedhë poshtë ankesën si të pabazuar.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj dhe vlerësoi ankesën gjeti se:

- *Ankesa është e pa bazuar*

Paneli me rastin e shikimit të shkresave të lëndës, vlerësoi se ankesa është e pabazuar pasi që paraqitësi i ankesës nuk ka bashkangjitur asnjë provë si dëshmi, dhe si e tillë nuk mund të vërtetohet se nga ana e kandidatit për kryetar të komunës së Prishtinës nga subjekti politik LDK, është bërë shkelje e nenit 36 paragrafi 1 i Ligjit NR.08/L-228, për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, ku parashihet se *“personi i cili mban pozitë publike i zgjedhur apo i caktuar nuk mund të përdorë atë zyrë apo ndonjë nga pasurit e saj me qëllim të përfitimit të votave. Asnjë nga burimet e asnjë institucioni të administratës publike qoftë të nivelit qendror ose lokal ose edhe ndonjë ndërmarrje në zotërim ose të kontrolluar nga autoritetet qendrore ose lokale nuk mund të shfrytëzohet ose të futen në mbështetje të ndonjë subjekti politik në zgjedhje”*.

Sipas vlerësimit të Panelit nga provat e bashkangjitura nuk ka mundur të vërtetohet shkelja e pretenduar dhe si e tillë nuk ka mundur të argumentohet në mënyrë të qartë dhe bindëse se kandidati për kryetar të komunës së Prishtinës nga subjekti politik LDK Përparim Rama duke shfrytëzuar pozitën publike ka bërë fushatë zgjedhore objektet publike gjegjësisht Ndërmarrjen Publike Pastrimi dhe Ndërmarrjen Publike Banesore SH/A se i njëjti ka, për të zhvilluar fushatë për Subjektin Politik PDKRL, ashtu siç pretendon pala ankuese. Kjo pasi që procesi i xhirimit dhe publikimit është kryer shumë më herët në kuadër të detyrave të rregullta institucionale, dhe jo gjatë fushatës së vitit 2025. Po ashtu në rastin konkret bëhet fjalë për prezantim të projekteve dhe rezultateve të arritura gjatë mandatit të tij si kryetar, pasi që i njëjti ka qenë kryetar i komunës përkatëse për të cilën kandidon përsëri, gjë që është praktikë e zakonshme në fushata zgjedhore në Kosovë dhe kudo tjetër, andaj nga këto arsye Paneli e ka refuzuar si të pa bazuar ankesën e palës ankuese.

Andaj duke u mbështetur në nenin 117.3 të LZP-së ku përcaktohet se: *“vendosja për ankesat nga PZAP-ja mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse”*, Paneli vlerësoi se pretendimet e tilla janë të pa qëndrueshme dhe si të tilla i refuzoj, për faktin se nga veprimet e përshkruara në ankesë parashtruesi i ankesës nuk ka arritur që të vërtetojë se këto veprime që paraqesin shkelje të dispozitave të lartcekura të LZP-së apo të Rregullës Zgjedhore Nr.07/2024, janë bërë pikërisht nga kandidati i LDK-së për kryetar të komes të Prishtinës, dhe si të tillë të njëjtën e refuzoi si të pabazuar.

Nga arsyet e theksuar më lartë duke bazuar nenin 117 paragrafi 3, neni 118 paragrafi 1 të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA

ZL.Anr.129/2025 më datën 10.10.2025

Kryesues i Panelit,

Arsim Hamzaj



KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Republikës së Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.